

MBI ZHVILLIMET NË STATISTIKAT FISKALE TË QEVERISË

Ermira Skënderi
Ministria e Financave

MBI ZHVILLIMET NË
STATISTIKAT FISKALE TË QEVERISË

1. Një tipar i ri i punës së Ministrisë së Financave ka qenë rritja e vazhdueshme e transparencës dhe e informimit të publikut mbi situatën fiskale dhe zhvillimet përkatëse. Vënia e informacioneve fiskale në dispozicion të publikut të gjerë dhe të institucioneve është realizuar, jo vetëm nëpërmjet prodhimit dhe shpërndarjes së Buletinit Statistikor Tremujor të ministrisë, por edhe nëpërmjet informimeve periodike mujore dhe konferencave të shtypit të herëpashershme të dhëna nga Ministri i Financave.

- Në fillim të vitit 1998 u botua për herë të parë, në vitet e tranzicionit, buletini tremujor "Statistikat Fiskale të Qeverisë".
- Gjatë vitit 1997, filloi praktika e zhvillimit të konferencave të shtypit të Ministrisë së Financave, si një mjet i komunikimit me publikun.
- Konferenca e parë e shtypit të Ministrisë së Financave, për vitin 2000, vuri një theks të rëndësishëm në programin e Ministrisë së Financave në fushën e statistikave fiskale.
- Aktualisht, krahas botimit tremujor, në mënyrë periodike, pothuajse për çdo muaj, jepen informacione mbi zhvillimet në financat publike, në formën e deklaratave për shtyp, të konferencave të shtypit apo të artikujve në gazetë.
- Që në vitin 1997 filloi praktika e përgatitjes së informacionit mbi statistikave fiskale sipas standardeve ndërkombëtare (GFS), të cilat publikohen rregullisht në botimet vjetore të FMN-së.

2. Aktualisht, Ministria e Financave po zbaton një program pune të posaçëm për përmirësimin e punës në publikimin e të dhënave statistikore, **që lidhen me Sektorin Fiskal, pra me Operacionet dhe Borxhin e Qeverisë. Ky program, ka si element bazë transparencën e procedurave dhe të praktikave të prodhimit të statistikave dhe është hartuar me asistencën e ekspertëve të FMN, në kuadër të iniciativës së re të ndërmarrë nga ky institucion për GDDS, ose Sistemi i Përgjithshëm i Përhapjes së të Dhënave.**

- Përkrahja nga Shqipëria e iniciativës së re të ndërmarrë nga FMN në kuadër të GDDS, është një shprehje e transparencës së plotë të Qeverisë Shqiptare, duke patur parasysh konceptin e GDDS.
- Për më tepër, interesimi nga vetë autoritetet shqiptare për të patur Shqipërinë si vend pilot për vendet e Europës Lindore, është shprehje e angazhimeve serioze për përmirësime në të ardhmen.
- Në këtë kontekst, përgatitja e dokumentit të quajtur Metadata, nga Banka e Shqipërisë, INSTAT-i dhe Ministria e Financave, me asistencën e ekspertëve të FMN-së, i cili do të shërbejë si program i përbashkët pune për autoritetet shqiptare dhe për FMN-në për një periudhë afatgjatë, është njëkohësisht edhe institucionalizimi i këtyre angazhimeve.

Përfshirja e Shqipërisë në këtë iniciativë dhe në këtë sistem, nënkupton përmirësimin e punës për të kapërcyer nga niveli aktual i prodhimit dhe i publikimit të të dhënave statistikore në fushën e financave publike si pjesë e statistikave makroekonomike, në një nivel më të avancuar mbi bazën e një koncepti më të gjerë, që përfshin:

- zgjerimin e informacionit mbi operacionet e qeverisë dhe mbi borxhin e qeverisë, që mund t'i ofrohet publikut;
- angazhimin e Ministrisë së Financave së bashku me Bankën e Shqipërisë dhe INSTAT-in, posaçërisht për publikimin dhe diseminimin e të dhënave kombëtare, duke i konsideruar ato përgjegjësi të drejtpërdrejta të institucioneve;
- ofrimin e informacionit të zgjeruar për publikun, në përgjithësi, duke mos u kufizuar vetëm në institucionet e përhira deri tani, apo ato që kanë paraqitur interes (përfshirë edhe individët);

- përgatitjen e të dhënave dhe të informacionit mbi financat publike në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe publikimin e tyre edhe për përdoruesit e brendshëm;
 - përdorimin e formave të reja, më të avancuara për shpërndarjen e të dhënave, duke përdorur krahas botimeve tremujore dhe publikimeve mujore edhe mjetet e reja elektronike, si disketat, kasetat, CD-ROM, internet.
- 3. Në kuadër të zbatimit të iniciativës mbi Sistemin e Përgjithshëm të Përhapjes së të Dhënave (GDDS,) Shqipëria është zgjedhur si vend pilot. Përkrahja e kësaj iniciative, përveç sa përmendëm më sipër, përban njëkohësisht edhe 2 momente të tjera mjaft të rëndësishme:**

Së pari, faktin që Shqipëria plotëson në mënyrë të kënaqshme kërkesat dhe standardet ndërkombëtare në lidhje me përgatitjen e statistikave fiskale dhe me transparencën e tyre ndaj publikut; dhe,

Së dyti, angazhimin e Qeverisë Shqiptare jo vetëm për të ruajtur nivelin e arritur të transparencës ndaj publikut, por për ta ngritur atë në standardet ndërkombëtare, sipas një programi 3 deri 5 -vjeçar, të hartuar posaçërisht.

Në këtë program, janë projektuar të zbatohen dy grupe angazhimesh, afatshkurtra dhe afatmesme.

Në një periudhë afatshkurtër (përgjithësisht për t'u realizuar brenda vitit 2000):

- Publikimi i tabelave përmbledhëse të GFS në buletin "Statistikat Fiskale të Qeverisë" për çdo tremujor, duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2000, duke dhënë edhe sqarimet e nevojshme rreth ndryshimeve në metodologji.
- Publikimi i kalendarit të botimeve në avancë.
- Publikimi si zë më vete, në buletin statistikor tremujor të:
 - a) detyrimeve të papaguara të borxhit të jashtëm;
 - b) borxhit të jashtëm të garantuar nga Qeveria;
 - c) borxhit të jashtëm të Bankës së Shqipërisë.
- Publikimi i të dhënave mbi borxhin e jashtëm, duke shtuar klasifikimin sipas maturitetit dhe llojit të monedhës.

Për një periudhë afatmesme janë programuar:

- Publikimi i parashikimeve disavjeçare lidhur me shërbimin e borxhit.
- Diseminimi i të dhënave nëpërmjet internetit.
- Vendosja e lidhjes elektronike midis Drejtorisë së Borxhit të Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë.
- Krijimi i *database* për evidentimin e borxhit të jashtëm të sektorit privat.
- Aplikimi i sistemit të ri të llogarive të qeverisë mbi të drejtat e konstatuara (accrual), nga sistemi aktual (cash) jo më vonë se viti 2005.

Aktualisht, jemi në fazën e marrjes së masave për zbatimin e veprimeve të programuara për periudhën afatmesme, ndër të cilat pjesa më e madhe ka të bëjë kryesisht me menaxhimin e informacionit në fushën e operacioneve fiskale të qeverisë si dhe në fushën e borxhit të jashtëm të Shqipërisë, përfshirë sektorin privat. Gjithashtu, ato lidhen me aplikimin e metodologjisë bashkëkohore në sistemin e llogarive të qeverisë mbi të drejtat e konstatuara (accrual), brenda një periudhe 5-6 - vjeçare.

4. Dimensionet e programit mbi zhvillimin e statistikave fiskale të qeverisë, i shikojmë në lidhje me 4 drejtime kryesore: *statistikat makroekonomike, përmirësimi i menaxhimit të financave publike, transparenca me publikun dhe marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtare.*

- *Në sfondin e statistikave makroekonomike:* përgatitja e statistikave fiskale të qeverisë në përputhje me kërkesat për përpilimin e llogarive kombëtare nga INSTAT-i.
- *Në sfondin e përmirësimit të menaxhimit të financave publike:* përgatitja e statistikave fiskale të qeverisë në përputhje me kërkesat bashkëkohore të menaxhimit të financave publike, duke orientuar përpunimin e informacionit statistikor sipas funksioneve të qeverisë dhe të sektorëve ekonomike, si bazë: a) për kryerjen e analizave për zbatimin e programit financiar dhe të politikave sektoriale të qeverisë; dhe, b) për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm, dhe hartimin e buxhetit vjetor mbi bazën e prioritetëve sektoriale afatmesme.

- *Në sfondin e transparencës me publikun:* konsolidimi i nivelit të arritur të transparencës ndaj publikut dhe ngritja e tij në nivelin e standardeve ndërkombëtare.
- *Në sfondin e informimit të institucioneve ndërkombëtare dhe të përgatitjes së statistikave ndërkombëtare:* përgatitja e statistikave fiskale të qeverisë në përputhje me standardet ndërkombëtare, në pikëpamje të definicionit, të besueshmërisë dhe të afatit të përgatitjes dhe raportimit të të dhënave.

5. Zbatimi i programit në fushën e statistikave fiskale, aktualisht, shikohet edhe si pjesë integrale e një programi tërësor afatmesëm të Ministrisë së Financave në fushën e menaxhimit të shpenzimeve publike. Ky program, mbështetet nga projekti mbi Reformën e Administrimit Publik, i hartuar me asistencën e Bankës Botërore, komponenti i parë i të cilit, është pikërisht menaxhimi i shpenzimeve publike. Ky projekt, përveç elementeve të përmirësimit të parashikimeve afatmesme dhe të formulimit të buxhetit, përfshin elemente të rëndësishme me ndikim të drejtpërdrejtë në përgatitjen e informacionit statistikor në fushën e financave publike:

- a) që nga elementet e asistencës së huaj dhe të kualifikimeve të stafit të ministrisë deri tek përmirësimet e teknologjisë së informacionit; dhe,
- b) që nga fuqizimi i funksioneve të thesarit dhe i funksioneve të kontabilitetit, deri tek fuqizimi i kapaciteteve të menaxhimit të përgjithshëm të Ministrisë së Financave.